

Të nderuar qytetarë të komunës së Zhelinës

Të dashurit e mi,

Sfidat me të cilat sot ballafaqohet Komuna e Zhelinës janë të shumta! Jemi para një momenti historik të zhvillimit të Zhelinës tonë. Komuna jonë ka pozitën më të mirë gjeografike në Maqedoni. Edhe pse ndodhet në zemër të zonës së lirë ekonomike, dhe paraqet ‘urë’ lidhëse ndërmjet dy qendrave kryesore të shtetit, Shkupit dhe Tetovës, si pasojë e keqqueverisjes nga pushteti i deritanishëm, komuna jonë radhitet ndër komunat më të varfra në Maqedoni.

Ne si Lëvizje Besa Ju sigurojmë se me udhëheqjen tonë do të fillojë një epokë e re për komunën e Zhelinës, dhe këto resurse që na i ka falë Zoti, do t’i shfrytëzojmë maksimalisht që ju të jetoni një jetë më të mirë.

Komuna e Zhelinës, me pushtetin e deritanishëm nuk ka mundur të prosperojë për shkak të nivelit të lartë të korrupsionit, partizimit të skajshëm të administratës komunale si dhe uzurpimit të pronës publike, që kanë pamundësuar realizimin e shumë projekteve të rëndësishme infrastrukturore. Ne jemi të bindur se vetëm nëse ndalen këto keqpërdorime, në Zhelinë krijohet klimë e favorshme për të pasur mirëqenie për çdo individ që jeton në vendbanimet e komunës tonë. Ky do të jetë objektivi jonë kryesorë.

Ne do të angazhohemi maksimalisht për një komunë në shërbim të qytetarëve dhe jo partisë, një komunë me administratë profesionale dhe transparente. J’ua japim Besën, se komuna e Zhelinës do të jetë një komunë shembullore në Maqedoni.

Të dashurit e mi, ky do të jetë detyrim i imi, që komuna e Zhelinës t’iu kthehet qytetarëve dhe përfundisht të eliminohet trysnia politike ndaj të gjithë atyre që mendojnë ndryshe dhe që janë të punësuar në administratën komunale ose në institucionet e themeluara nga Komuna.

Me moton “për një jetë të re”, banorët e Zhelinës do të jenë të lirë dhe do ta ndjejnë komunën si institucion që i’u shërben atyre pavarësisht bindjeve të tyre politike. Perëndia i ka falë njerëzit të lirë dhe askush nuk ka të drejtë t’i robërojë ata!

I juaji,

Blerim Sejdiu

VIZIONI PËR NJË KOMUNË TË ZHVILLUAR

Komuna e Zhelinës përbëhet nga tetëmbëdhjetë fshatra, me afër 30.000 banorë, dhe sipërfaqe prej 199 km². Komuna jonë, ka pozitën më të volitshme gjeografike të shtrirjes së saj edhe atë: në jug-lindje dhe veri-perendim, ajo i takon Pollogut të poshtëm, e në anën e djathtë të lumit Vardar, me pjesën e Malit të Thatë, depërton deri në rrjedhën e lumit Treska. Komuna e Zhelinës kufizohet me pasuritë më të mëdha të Maqedonisë veri-perëndimore: Liqenin e Matkës dhe Treskës, përmes fushës së Pollogut arrinë te malet e Sharrit u bën pjesë edhe Kodra e Diellit.

Territori i komunës karakterizohet me vendbanime të rrafshëta dhe vendbanime kodrinore-malore. Kjo sipas organizimit territorial kufizohet me komunën e Tetovës, Bërvenicës, Bogovinës, Jegunovcës dhe Sarajit.

Vendbanimet që e përbëjnë komunën e Zhelinës janë: Zhelina, ku është selia e komunës, Cerova, Çifliku, Dëberca, Grupçini, Leshnica e poshtme, Leshnica e epërme, Llërca, Llukovica, Kapazhdolli, Merova, Novo Sella, Pallatica, Roglja, Strimnica, Treboshi, Sellareva dhe Uzurmishti.

Këto vendbanime janë të banuara kryesisht me popullatë shqiptare muslimane edhe atë: 99.9%, kurse vetëm 0.01% zënë vend popullata maqedone dhe të tjerë.

Ne gjatë mandatit tonë do të përkushtohemi në mënyrë të veçantë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe ngritjen e infrastrukturës në të gjitha këto vendbanime.

Lista e këshilltarëve

1. Liridon Useini, f.Zhelinë
2. Mubine Abdii, f.Stërmnicë
3. Sedad Rushani, f.Trebosh
4. Lazim Idrizi, f.Pallaticë
5. Nagip Selmani, f.Debërcë
6. Elmedina Rexhepi, f.Çiflik
7. Suad Alili, f.Stërmnicë
8. Ixhet Alija, f.Merovë
9. Arjeta Xhemaili, f.Grupçin
10. Sheqibe Ajdari, f.Novo Sellë
11. Sinan Sherifi, f.Rogle
12. Emira Ibishi, f.Llërcë
13. Arbenita Gafuri, f.Trebosh
14. Egzona Aliji, f.Zhelinë
15. Amir Limani, f.Pallaticë
16. Egzan Limani, f.Debërcë
17. Agim Ajdari, f. Leshnicë e Epërme
18. Hatixhe Ajdini, f.Zhelinë
19. Nuhi Kamberi, f.Kapazhdoll

ZOTIMET E LËVIZJES BESA PËR NJË JETË TË RE PËR ZHELINËN

1. Arsimi

Investimi jonë parësor do të jetë në arsim cilësor. Kemi parashikuar rikonstruimin e shumicës së shkollave të shkatërruara si në Pallaticë, Strimnicë, Llërcë, Çiflik, Grupçin, Trebosh, Rogle dhe Sallarevë. Në fshatin Cerovë dhe Leshnicë e poshtme do të ndërtohet shkollë e re. Procesi edukativo – arsimor do të zhvillohet në kushte optimale për çdo nxënës duke evituar njëherë e përgjithmonë problemet të natyrës teknike, të cilat kanë

qenë pengesë për arritje të cilësisë. Përcaktimet tona janë: depolitizimii institucioneve, arritja e kushteve optimale në shkolla dhe fokusimi në rritjen e cilësisë nëpërmjet aktiviteteve konkrete.

Për ngritjen e cilësisë së arsimit në komunën tonë do të përpiqemi të hartojmë një strategji të hapjes dhe komunikimit me shkolla të tjera, me qëllim të këmbimit të përvojave. Me rëndësi të veçantë është edhe stimulimi i kycjes së nxënësve dhe arsimtarëve në projekte ekologjike, aktivitete të sporteve alternative dhe në kultivimin e vlerave tradicionale. Me qëllim të arritjes së cilësisë në arsim, fokusimi ynë do të jetë në:

- o Depolitizimin e arsimit;
- o Rikonstruimin e shkollave ekzistuese;
- o Ndërtimin e shkollës në fshatin Leshnicë e poshtme;
- o Ndërtimin e shkollës në fshatin Cerovë
- o Ndërtimin e një çerdheje në nivel komunal;
- o Furnizimin e shkollave me mjete të mjaftueshme për zhvillimin e procesit arsimor;
- o Shpërblimin e nxënësve të dalluar;
- o Përkrahjen e plotë për projektet e inicuar nga shkolla (organizime: gara, manifestime, seminare, trajnime, ekskursionet, etj.);
- o Funkcionalizimin e bibliotekave në shkollat qendrore.

2. Kultura

Administrata e re do të angazhohet për hartimin e një skeme programore në nivel komunal, me qëllim që mundësisht të përfshihet çdo vendbanim. Projektet kulturore kanë një impakt të fuqishëm për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, në vlerat familjare, shoqërore, etj. Në këtë drejtim si drejtues i Komunës së Zhelinës do të angazhohem që të përfshihen projekte si në vijim:

- o Themelimin e grupeve muzikore (muzikës së lehtë dhe asaj popullore);
- o Organizimin e festivaleve për fëmijë;
- o Stimulimin e artistët figurativë dhe shkrimtarëve që gravitojnë në komunën tonë;
- o Shënimin e festave kombëtare dhe fetare;
- o Organizimin e takime tradicionale me mërgimtarët e komunës sonë;
- o Përkujdesen e veçantë për lapidarët e dëshmorëve dhe monumenteve historike.

3. Rinia dhe sporti

Sporti do të jetë ndër shtyllat kryesore gjatë mandatit tonë. Në këtë aspekt do të riorganizojmë klubet futbollistike ekzistuese duke iu ndihmuar atyre me materiale të ndryshme sportive dhe përkrahje maksimale për kualifikim në gara të ndryshme. Përveç kësaj, duke e pasur parasysh pozitën e komunës së Zhelinës ne do të angazhohemi edhe për zhvillimin e sporteve alternative si: alpinizëm, marshim, çiklizëm malor, etj. Fatkeqësisht, sot i riu nuk ka ASNJË alternativë për aktivitet sportiv. Mungojnë: terrene sportive, pishina, shtigjet për vrapim dhe çiklizëm, guida për alpinizëm, klube shahu, etj. Andaj, krahas përkrahjes së ideve alternative dhe inovative për zhvillimin e sportit do të angazhohemi për ndërtimin e:

- a. Fushave sportive multifunktionale nëpër fshatrat e komunës;
- b. Themelimin e qendrës rinore në kuadër të komunës, të cilën të rinjtë do ta shfrytëzojnë për iniciimin dhe realizimin e projekteve të ndryshme;

- c. Ndërtim i këndeve për fëmijë;
- d. Rikonstruim dhe thurje e fushave të sportit,
- e. Ndërtim i disa parqeve;
- f. Ndërtim i disa qendrave rekreative;
- g. Shpallje e disa vendeve si shetitore.

4. Shëndeti publik dhe përkujdesja sociale

Udhëheqësia lokale ka për detyrë të përkujdeset për mirëqenien dhe shëndetin e banorëve të saj dhe të intervenojë në kohë. Kjo filozofi e përmbajtjes së komuniteteve dhe banorëve kërkon angazhim të pushtetit lokal në mirëmbajtjen e shëndetit dhe mirëqenies së banorëve si kapitali më i madh i komunës.

Fokusimi jonë do të jetë në:

- a. Përkrahjen e familjeve në nevojë, me ndihmën e ndërmarrjeve të ndryshme që funksionojnë në kuadër të komunës.
- b. Themelim i një ekipi i cili do të vlerësojë shkallën e rrezikshmërisë dhe cenimit të shëndetit publik;
- c. Përkrahjen për familjet në rast të fatkeqësive të ndryshme;
- d. Themelimi i një zyre në nivel komunal për përkujdesje sociale.

5. Ambienti i shëndoshë jetësor

Ambienti jetësorë viteve të fundit është bërë obligim i joni duke bërë që sot para banorëve të dalim me një premtim: ta mbrojmë TË DREJTËNE FRYMËMARRJES. Gati se të gjitha vendbanimet e komunës së Zhelinës ballafaqohen me problemet e deponive: Leshnica e sipërme, Dëbërca, Pallatica, Strimnica, Merova, Sallareva, Çifliki. Masat fillestare që do të merren nga administratat komunale janë:

- a. Zgjidhje afatgjate e problemit të mbeturinave;
- b. Përkujdesje e veçantë ruajtjes së ambientit;
- c. Pastrimi dhe larja e rrugëve;
- d. Organizim i aktiviteteve edukuese dhe senzibilizuese për çështjet ekologjike;
- e. Inspektim i rregullt i ndotësve të ambientit (ujit, ajrit dhe zërit).

6. Llogaridhënia ndaj qytetarëve

Sipas hulumtimeve, rezulton se administratat e komunave janë institucione me më pak transparencë dhe përgjegjësi, ku qytetarët që kanë trokitur së paku njëherë në derën e saj kanë mbetur të zhgënjyer. Zhgënjimet e qytetarëve janë të natyrave të ndryshme: mosprezenca e administratorëve në vendin e punës, mospranimi dhe mohimi i përgjegjësisë për punët caktuara, vonesate panevojshme etj.

Vizioni ynë është që me përkrahjen e të gjithëve bashkërisht ta ndërtojmë një administratë funksionale dhe në shërbim të qytetarëve. Parim në punën e komunës do të jetë “komuna e qytetarit dhe për qytetarin”, ku ata me sugjerimet, propozimet dhe parashtrimin e ankesave në mënyrë të drejtpërdrejtë do i ndihmojnë edhe qytetarit, i cili nuk ndjen detyrim në parashtrimin e ankesave. Ne ndjejmë detyrim që administrata komunale të bazohet në kërkesën e qytetarit dhe feedback-un e qytetarit. Synojmë të arrijmë:

- a. Administratë komunale në shërbim të qytetarëve me transparencë të plotë;
- b. Participim të qytetarëve në përpilimin e buxhetit të komunës si dhe mundësi kontrolli në realizimin e buxhetit;
- c. Realizim të plotë të investimeve kapitale nga mjetet e planifikuara nga buxheti;
- d. Buxhetim participativ;

e. Transparencë të raporteve financiare vjetore.

7. Zhvillimi ekonomik lokal

Lëvizja Besa një përkujdesje të veçantë do t'i kushtojë edhe zhvillimit ekonomik lokal. Edhe përkundër faktit se Maqedonia nuk e përmbylli me sukses procesin e decentralizimit, që t'ju mundësojë komunave mjete nga burime të brendshme për zhvillim ekonomik lokal, këto të fundit duhet të gjejnë alternativa të qëndrueshme për përkrahje të biznes ideve të reja. Lëvizja BESA do të angazhohet që qendrën për zhvillim ekonomik rajonal që do t'i përshijë disa komuna rreth Tetovës, ta vendos në funksion të përkrahjes konkrete të ideve afariste të qytetarëve, veçanërisht në shërbim të këtyre ideve që vijnë nga mërgimtarët tanë. Në këtë aspekt rëndësi të veçantë do t'i kushtojmë edhe stimulimit të prodhimitarisë pjellore.

8. Turizmi, shtylla kryesore e zhvillimit ekonomik

Komuna e Zhelinës ka pozitën më të mirë edhe të turizmit. Nga viset malore në mënyre imponante kufizohet me liqenin e Matkës, në afërsi prej 3 km ka zonën e lirë ekonomike dhe vetëm 5 km e ndanë me Malin Sharr.

Ndërvarësia në mes parametrave të ndryshëm, si: pastërtia e ambientit, politikat e pushtetit qendror kundrejt pushtetit lokal, pastaj përqendrimi i interesave të pushtetit lokal në interesa personale, kanë ndikuar në degradimin e turizmit në gjithë komunat e vendit. Administrata komunale fillimisht do të përqendrohet në tejkalimin e barrierave ligjore, pastaj hapi i radhës do të jetë përpilimi i strategjisë afatgjate për zhvillimin e turizmit.

9. Buxheti participativ

Buxheti participativ nënkupton inkuadrimin e komunitetit lokal në procesin e vendimmarrjes ose në përcaktimin e prioritetëve që do të financohen nga pushteti lokal. Duke implementuar këtë mekanizëm, do të arrihet inkuadrimi i qytetarëve dhe grupeve të ndryshme të interesit të diskutojnë për prioritetet, të ofrojnë propozime dhe të vendosin me anë të mekanizmave të demokracisë së drejtpërdrejtë. Një përqindje e buxhetit të brendshëm do të dedikohet për projekte që do të jenë prioritet për komunitetin, ndërkaq bashkësitë lokale do të jenë platforma për të aktivizuar qytetarët që vetë të vendosin për prioritetet e komunitetit.

10. Nga komuniteti për komunitetin

Komunat do t'i ndjekin dhe do t'i ndihmojnë kompanitë që i kushtojnë kujdes qëndrueshmërisë sociale dhe mbrojtjes së ambientit. Komuna do të inicojë projektin “nga komuniteti për komunitetin”, me të cilin:

- a. Do t'u ofrojë mbështetje financiare kompanive, të cilat tregojnë nivel të lartë të përgjegjësisë korporative sociale.
- b. Komuna do të monitorojë dhe do të punojë në ngritjen e vetëdijes së kompanive të cilat nuk kanë treguar gatishmëri që një pjesë të profitit ta kthejnë te komuniteti me format e përgjegjësisë sociale korporative.

11. Bashkëpunimindërinstitucional

Do të ofrojmë një kornizë institucionale për inkuadrin të vazhdueshëm të ekspertëve, sektorit privat dhe shoqërisë civile në përcaktimin e prioritetëve dhe politikave publike në nivel lokal. Trajnimet dhe seminarët me sektorin privat dhe shoqërinë civile do të jetë në funksion të fuqizimit të aplikimit dhe sigurimit të fondeve nga programet IPA, në hartimin e planeve strategjike dhe monitorimin e politikave publike lokale.

12. Urbanizmi

Prioritet në sektorin e urbanizmit, në administratën komunale, do të jetë qasja më serioze ndaj problemeve të bashkësive lokale, ku do të diskutohet: urbanizimi i fshatrave, hapja dhe mirëmbajtja e rrugëve, shqyrtimi dhe sanimi i anomalive të ujësjellësit, riparimi dhe zgjerimi i rrjetit ekzistues fekal etj.

13. Infrastruktura

Përkundër premtimeve të shumta në dekadën e fundit, infrastrukturat e komunave jo që kanë shënuar progres, por janë katandisur në formën më të keqe të mundshme. Në ato pak rrugë që janë meremetuar vërejmë gropa të mëdha, të cilat formohen si pasojë e punës jocilësore dhe që për pasojë ka sjellë dëmtimin e ujësjellësit dhe kanalizimit të ujërave të zeza. Rastet e këtilla dhe shumë raste të tjera, që shfaqen si huqje e logjikës së shëndoshë ndërtuese, jo që e ndihmojnë infrastrukturën, por me efektet anësore e vështirësojnë akoma më tepër jetën e banorëve.

Roli i administratës së ardhshme në ndërtimin e infrastrukturës së banorëve do të bazohet në analizimin e gjendjes faktike të procesit të ndërmarrë, pastaj planifikimin e saktë të tij dhe realizimin e punës në bazë të standardeve të kërkuara. Në aspektin praktik ne do të angazhohemi në:

- a. Riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve nëpër fshatrat e komunës.
- b. Rregullimin e trotuareve nëpër vendbanime
- c. Rregullimin dhe pastrimin e shtratit të lumenjve.
- d. Angazhim për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e ujësjellësit.

14. Komunikacioni

Njëri nga faktorët kryesorë të mirëqenies së banorëve të një vendbanimi është funksionimi i transportit dhe komunikacionit në përgjithësi. Vite me radhë komunikacioni në vendbanimet kanë qenë një sfidë e vërtetë, që ka drejtpërdrejtë ndikuar në aspektin financiar të banorëve.

Do të angazhohem që të kemi një transport publik gjithpërfshirës dhe me termine të shpeshta. Do të sigurojmë që të kemi transport publik falas për rastet e caktuara si pensionistët dhe rastet sociale, studentët të dalluar etj.

Fokusimi jonë do të jetë edhe në krijimin e kushteve përmes linjave të transportit publik në bashkëpunim me komunate tjera.

Realizimi i programit

Lista e gjatë të punëve që na presin detyrimisht shtron pyetjen, se me çfarë mjetesash financiare do të bëhen të gjitha këto projekte? Prandaj duam të shpjegojmë se:

- një pjesë projekteve do të realizohet me lehtësi vetëm me financat me të cilat disponon komuna, natyrisht kur të ndalet korrupsioni dhe abuzimi me financat e saj.
- një numër i caktuar i projekteve do të realizohet përmes aplikimit për grante që i jep BE-ja për zhvillimin e komunave.

- pjesa e tretë e projekteve do të realizohet përmes aplikimit në institucione qendrore dhe të tjera ndërkombëtare, që japin donacione për zhvillimin e zonave më pak të zhvilluara.

Për këtë qëllim, kemi vënë kontakte me institutin slloven "Arti future", i cili përgatit projekte dhe ndihmon në gjetjen e donatorëve. Jemi të sigurt se, do të jetë mundësi e shkëlqyer që së bashku me këtë institut të hartohen projekte dhe ato të gjejnë donatorë. Realizimi i marrëveshjes tonë me banorët e Zhelinës do të mbështetet edhe nga Oda ekonomike BGA e Gjermanisë, Shoqata ekonomike gjermano-shqiptare, etj.

Marrëveshja

Ky program zgjedhor është njëherazi edhe kontratë me votuesin gjatë katër viteve të ardhëshme të administrimit tonë në Komunë do të mund të na përcjellë nëse u përmbahemi këtyre premtimeve dhe pastaj t'a vlerësojnë punën tonë.

“për një jetë të re” në Zhelinë

Ne E JAPIM BESËN PËR Zhelinën!